



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2019:295412

Datë: 04.09.2024

Numri i dokumentit: 06121613

C.nr.1601/19

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Afërdita Mulhaxha, në çështjen juridiko-civile të paditësit: B.L., nga P., të cilin e përfaqëson Mustafë Kastrati, avokat në Pejë, kundër të paditurve: Ministria e Punëve të Brendshme, në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Naim Krasniqi, avokat shtetëror, në Prishtinë, dhe Komuna e Pejës, të cilën e përfaqëson e autorizuar Drita Sopi Gashi, avokate në Prishtinë, për shkak të kompenzimit të dëmit, vlera e kontestit 64.598€, në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.28.08.2024, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarit të tij, e në mungesë të autorizuarve të të paditurave, me dt.29.08.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET kërkesë padia e paditësit B.L., nga P., me të cilën ka kërkuar që të:
„DETYROHEN të paditurat: Ministria e Punëve të Brendshme, në Prishtinë, dhe Komuna e Pejës, që në emër të kompenzimit të dëmit material dhe jo material, të i paguajnë shumat siç vijon: në emër të dhembjeve fizike shumë prej 10.000,00€, në emër të frikës shumë prej 8.000,00€, në emër të ZAPJ për 20% shumë prej 9.000,00€, në emër të ZAP për 27% shumë prej 4.672,93%, në emër të rentës mujore nga data 30.12.18-31.05.24, kurse nga data 01.06.24 e tutje deri sa për këtë të ekzistojnë kushtet ligjore shumë mujore prej 71.82€ e cila duhet të paguhet deri me datën 5 të muajit vijues ose renta e kapitalizuar në shumë prej 11.466,00€.

Në emër të shpenzimeve të shërimit shumë prej 21.460,00€ ose totali prej 64.598,00€ me 8% kamatë duke filluar nga data 30.12.2018 e deri në pagesë definitive si dhe shpenzimet e procedurës sipas listës së shpenzimeve e të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga marrja e aktgjykimit e nën kërcënim përmbarimi.”, SI E PA BAZUAR.

A r s y e t i m

Paditësi nëpërmes të autorizuarit të tij, gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalës përfundimtare, ka parashtruar se me dt.....2018, në Pejë, në rrugën „”, rreth orës..., është plagosur me armë zjarri nga persona ende të pa njohur, ku ka marr plagë të rënda si rezultat i vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë, për çka ka qenë i detyruar që të kryej ndërhyrje kirurgjikale në Spitalin „Acibadem Sistina” në Shkup, dhe në Poliklinikën „Vozdmedik” në Beograd.

Intervenimi kirurgjik në Shkup, ka kushtuar 14.460€, ndërsa në Beograd, ka kushtuar 7.000€, e në tërësi totali i trajtimeve ka qenë 21.460€-shuma këto që nuk janë definitive sepse trajtimi mjekësor është ende në vazhdim...Ka theksuar se intenziteti i dhimbjeve të pësuar është i natyrës së rëndë, për shkak të mënyrës së lëndimit- për të gjitha këto ka prezentuar prova ne shkrim.

Ka theksuar se në bazë të rregullores 2000/45-neni 2.2 dhe Reg.2007/30 si dhe Kushtetutës së Kosovës... si dhe nenit 10.1 shkronja a të Ligjit 03/L-035... përcaktohet obligimi

i të paditurave...Gjykatës i ka propozuar që pas administrimit të provave të aprovoi kërkesëpadinë si të bazuar.

Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë kërkesëpadisë, dhe pas dhënies së mendimit, nga ekspertet mjekësor lidhur me lëndimet që i ka pësuar paditësi B..., në incidentin e përmendur, me dt.24.06.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë në harmoni me mendimin e ekspertëve.

I aut. i paditësit në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se me administrimin e provave në tërësi është vërtetuar legjitimiteti pasiv i të paditurave, baza dhe lartësia e kërkesës padisë. Ka potencuar se është vërtetuar fakti se paditësi si shtetas i Republikës, është plagosur në vend publikë pa asnjë faj, dhe kontribut në ngjarje, i njëjti ka besuar dhe beson se Kushtetuta dhe shteti i garantojnë jetën e tij personale dhe familjare, ashtu siç është përcaktuar me nenet 7.1, 12.1, 21.2 dhe 46.1 të Kushtetutës të Republikës, e cila garanton jetën dhe pasurin e shtetasve të saj. Po ashtu në bazë të nenit 10.1 a, të Ligjit 03/L-035 përcaktohet obligimi i të paditurës së dytë, që brenda kufijve të saj të siguron jetë të qetë banorëve.

Ka cekur se plagosja e paditësit është pasojë e lëshimeve të të paditurave, për të mos lejuar shtetasit që në vende publike të gjuajnë me armë, të mbajnë armë pa leje dhe aq më keq deri më sot të mos zbulon kryesit e kësaj vepre penale, rrjedhimisht paditësi ka argumentuar bazushmërinë e kërkesë padisë, andaj bazuar në faktin se shtetet e civilizuara krijojnë shtetin për të siguruar sigurinë e jetës dhe familjes, përndryshe do të mbizotëronte anarkia. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet kërkesës padia e precizuar si në parashtresën e fundit të dt.24.06.2024. Shpenzimet i ka kërkuar sipas listës dhe atë: për përpilim të padisë shumë prej 312€, për dy parashtresa shumë prej 312€, për taksë për padi shumë prej 100€, për ekspertizat e kryera shumë prej 400€, për përfaqësim në 11 seanca x 405,60€, shumë prej 3.240,60€, e në shumë të tërësishme prej 4.346,60€ të mbështetura në tarifatat e OAK-së.

I autorizuari i të paditurës së parë Naim Krasniqi, avokat shtetëror në Prishtinë, me përgjigje në padi të parashtruar me shkrim me dt.27.01.2022, ka potencuar se pretendimet e palës paditëse janë plotësisht të pa baza dhe të paqëndrueshme për nga gjendja faktike në drejtim të paditurës së parë .

Ka shtuar se pretendimet e paditësit për punën e policisë ka mundur me i paraqitur në Inspektoratin Policor, në rast se nuk është i kënaqur me punën e policisë...Ligji nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 136 bazat e përgjegjësisë...se kërkesa për shpërblimin e dëmit bie ndesh me neni 136 të LMD-së (*kush tjetrit i shkakton dëm ka për detyrë ta kompenzoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.*) dhe se përket i mungon legjitimiteti pasiv. Ka cekur se nga gjendja faktike e përshkruar shihet qartë se dëmi është shkaktuar nga persona të tjerë dhe nuk mund të sjellë përgjegjësinë e të paditurës MPB, pasi paditësit nuk i kanë shkaktuar dëmin dhe është jashtë kontrollit të tyre parashikimi i ngjarjeve të së ardhmes.

Se MPB ka marr të gjitha veprimet për të hetuar rastin, dhe nga provat e ofruara në këtë padi, nuk mund të shihet asnjë lëshim i policës së Kosovës, që do të mbante përgjegjësi ndonjë zyrtar policor, për lëshimet e bëra gjatë kësaj lënde, përderisa nuk dihet kryesi i veprës penale, nuk mund t'i vihet barra policisë, se derisa nuk vërtetohet përgjegjësia penale e kryesit të kësaj vepre, atëherë nuk mund të kërkohet dëmi nga MPB- Policia e Kosovës, sepse nuk mund të nisemi nga baza e parashikimeve se çka do të ndodhë në çdo pronë të qytetarëve.

Se legjitimiteti real pasiv nënkupton se pala e paditur e jo dikush tjetër ka obligim për përmbushjen e një prestimi të pretenduar të paditësit. Ka sqaruar se në rastin konkret autorizime ta mbrojnë palën nga aktet e dhunës, sjelle me vete përgjegjësin e zyrtarëve, dhe deri me tani nuk ka asnjë person që do të është përgjegjës, se nuk e ka kryer detyrën e vetë... Gjykatës i ka propozuar që të hudhet poshtë si e pa lejuar padia e paditësit, kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës- MPB- Prishtinë.

Gjatë shqyrtimit kryesorë i autorizuari i të paditurës së parë me parashtresa edhe me parashtresën e fundit të datës 08.04.2024, njëjtë ka deklaruar si në përgjigje në padi duke e kundërshtuar në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesën e saj, e kundërshton për shkak të

mungesës së legjitimitetit real pasiv, se pala e paditur e jo dikush tjetër, ka obligim për përmbushjen e një prestimi të pretenduar të paditësit...

Në seancën e fundit kur është bërë leximi i provave dhe dhënia e fjalës përfundimtare nuk ka prezantuar i autorizuari i paditurës së parë, dhe seanca është mbajtur në mungesën e tij konform nenit 423 LPK-së.

E autorizuara e të paditurës së dytë Drita Sopi Gashi, avokate në Prishtinë, në përgjigje në padi të dhënë me shkrim me dt.25.01.2022, ka deklaruar se e konteston padinë dhe kërkesën e saj, si të pa bazuar si nga baza ashtu edhe nga lartësia. Duke e arsyetuar se padia e padises është e pakuptueshme dhe nuk mban elemente thelbësore të padisë, nga se paditësi nuk ka prezentuar asnjë provë që dëshmon se e paditura e dytë ka ndonjë përgjegjësi juridike materiale për rastin lëndorë. Ka theksuar se nuk ka legjitimitet pasivë për të qenë palë, sepse veprimet e dëmit që mund ti ketë shkaktuar personi i tretë përmes „vrasjes në tentativë” të paditësit, e që nuk është zbuluar kryesi i veprës së dyshuar penale nga organet e sigurisë, së të paditurës së parë, kjo, nuk bijen në përgjegjësinë subjektive e as objektive, të të paditurës së parë. Sepse përgjegjësia penale për veper penale për çfardo obligimi për kompenzim rrjedh nga kryesi e jo për organet Komunale Administrative, dhe përgjegjësia penale e tjetrit nuk tërheq përgjegjësin materiale për organin shtetërorë, se këto janë gjëra të ndara me Kodin Penal.

Se të cekurat më lartë gjejnë mbështetje në nenin 2.2 të Rregullores së UNIMK- ut nr.2000/45(viti 2000)për Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe sipas KPPRK-së, dhe KPPK-së... se kërkesë padia së bashku me llojet e dëmit dhe lartësia e tyre të paraqitura në padi janë ekzagjeruar nga paditësi. Ka propozuar që të refuzohet në tërësi si e pa bazuar kërkesë padia e paditësit, pas administrimit të provave nga padia.

Gjatë shqyrtimit kryesor ka mbetur pranë kundërshtimeve dhe thënive nga përgjegjja në padi, nuk ka kundërshtuar nxjerjen e ekspertizave dhe sigurimin e provave penale, si çështje paraprake, duke ritheksuar se padisi mund të kërkoj dëmin nga vepra penale në procedurë penale, se nuk mund të mbahet përgjegjëse e paditura e dytë, për dëmin e shkaktuar nga personat e tretë nga veprimet inkriminuese penale, që do të thotë se e paditura e dytë, nuk ka përgjegjësi objektive e as subjektive...

Në seancën e fundit kur është bërë leximi i provave dhe dhënia e fjalës përfundimtare nuk ka prezantuar e autorizuari, dhe seanca është mbajtur në mungesën e saj konform nenit 423 LPK-së.

Siç u theksua me lartë shqyrtimi i fundit kryesor në propozim të autorizuarit të paditësit e me pajtimin edhe të autorizuarit të paditurës së parë të dhënë me parashtrësë, është mbajtur në mungesë të autorizuarve të të paditurave, rregullisht të ftuar, e në kuptim të dispozitës së nenit 423 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të gjendjes faktike dhe me propozimin e palëve zhvilloi procedurën e provave dhe në shqyrtimin kryesor u lexuan dhe shiquan: shkresat penale të dt.10.01.2019, kallëzimi penal; raporti njoftues nga PTH-Pejë-Departamenti i Krimeve të rënda dt.31.12.2018, raport mjekësorë nga Vozdmedik-policlinik i dt.21.03.2019; shkresat nga Spitali i Përgjithshëm Medical Centar i dt.02.04.2019; flet lëshimi nga Sistina i dt.31.12.2018; raporti mjekësor nga AURA të dt.27.02.2019; faktura për Sistinen: dt.03.01.2019, dt.15.01.2019; dt.15.01.2019, dt.25.02.2019, dt.18.02.2019, dt.12.02.2019, dt.13.02.2019, dt.28.02.2019, dt.06.02.2019, dt.06.03.2019, dt.21.02.2019; raporti mjekësorë i dt.14.02.2019 nga Sistina, i dt.18.02.2019, i dt.21.02.2019, raporti mjekësorë: dt.19.02.2019, dt.18.02.2019, dt.03.06.2019, dt.14.03.2019, dt.12.02.2019, dt.06.02.2019, dt.23.01.2019, dt.31.12.2018; raporti nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë, Emergjencia i dt.30.12.2018; ekspertiza e ekspertëve mjekësorë: Dr.Enver Mujaj-ortoped-traumatolog dhe Dr.Muhamet Halitaj-psikiatër; ekspertiza e Dr.spe.Qefsere Restelica –eksperte e mjekësisë së punës; ekspertiza aktuaristike-financiare, nga ekspertja Gresa

Shabani e dt.31.05.2024, dhe deklaratimet e të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, si dhe të gjitha shkresat tjera që gjenden në lëndë.

Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK, dhe arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko kontestimore duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-se paditësi B.L., nga P., , me dt. 18, rreth orës ..., është plagosur me armë zjarri, nga persona deri më sot ende të pa njohur.

Për këtë çështje janë zhvilluar hetimet nga ana e Policisë së Kosovës, dhe Prokurorisë Themelore në Pejë, i është përcjellë Raporti Njoftues me dt.....hetimet kanë vazhduar sipas procedurës, por pa sukses gjerë më tani, pasi që nuk është gjetur kryesi gjegjësisht kryesit e kësaj veprë penale...

Gjatë këtij incidenti paditësi ka marr lëndime të natyrës së rëndë, për çka paditësi është përcjellë për shërim të mëtutjeshëm prej QKUK-Prishtinë, për në Spitalin „Acibadem Sistina”, në Shkup, R e Maqedonisë së Veriut, dhe në Poli Klinikën Vozdomedik-Beograd, me ç’rast paditësit i janë shkaktuar shpenzime për mjekim, e për të cilat gjykatës i janë prezantuar faturat bashkë me raportet mjekësore nga këto qendra spitalore.

Sikurse është theksuar më lartë kryesi i kësaj veprë nuk është gjetur nga organet kompetente-Prokuroria Themelore Pejë, për këtë fakt është njoftuar gjykata me shkrim nga ana e Kryeprokurorit Z.Agim Kurmehaj, me përgjigje në kërkesën e Gjykatës me shenjë C.nr.....ë dt.30.03.20.. me të cilën është njoftuar Gjykata Themelore në Pejë, se që nga koha e kryerjes së veprës lëndore, përkatësisht që nga data....., nga ana e Prokurorisë, janë ndërmarrë veprime hetimore parapenale, në drejtim të identifikimit të kryesit/ve të kësaj veprë penale, mirëpo që deri me sot mbeten të panjohur për Prokurorinë.

Kjo Gjykatë, ka vërtetuar se në këtë incident paditësi B., ka përjetuar lëndime të rënda trupore, të cilat lëndime me egzaminim të drejtpërdrejt janë konfirmuar nga mendimi i ekspertëve mjekësor: Dr.Muhamet Halitaj-psikiatër dhe Dr.Enver Muja, ortoped-traumatolog, në seancën e dt.28.03.2023, i cili mendim bashkë me plotësim, nuk është kontestuar nga palët ndërgjyqëse, pas plotësimit të mendimit mjekësor.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi ka përjetuar lëndime të rënda trupore, në incidentin e dt.30.12.2018, Mirëpo kontestuese ka qenë se të paditurat a gëzojnë legjitimitetin real pasiv.

Gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike me propozimin e palëve i ka shqyrtuar shkresat që gjenden lëndë, e në veqanti ato para penale...e ato mjeksore..., me të gjitha këto prova është vërtetuar fakti se vërtet paditësi në incidentin e cekur më lartë, ka përjetuar lëndime të rënda trupore (fakt ky që nuk është kontestuar nga ndërgjyqësit) dhe ate nga kryesi/it ende të pa identifikuar...

Kjo gjykatë, sikurse është cekur më lartë ka vërtetuar pa dyshim faktin se paditësi B. i ka pësuar lëndimet në incidentin në fjalë, mirëpo gabimisht është përcaktuar legjitimitetin pasiv për arsyet që u dhanë më lartë...

E këtë bazuar në faktin se me dispozitat e LMD-së të Kosovës, me saktësi është përcaktuar principi i përgjegjësisë subjektive dhe objektive, ku sipas principit të përgjegjësisë subjektive është paraparë *se kush tjetrit i shkakton dëm është i obliguar ta kompenzoj dëmin e shkaktuar, po që se nuk ka kushte ligjore që të përjashtohet nga përgjegjësia, që do të thotë, principi i përgjegjësisë subjektive bazohet në fajin e personit përkatësisht shkaktarit të dëmit... e që në rastin konkret nuk dihet shkaktari i incidentit...*

Andaj, vendimi i Gjykata gjen mbështetje në dispozitën e nenit 154 të LMD-së, *që ishte në fuqi* kur është krijuar ky raport juridik, me të cilën dispozitë parashihet se,, *dëmi i shkaktuar*

lidhur me sendin e rrezikshëm, përkatësisht me veprimtarinë e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ky send, përkatësisht nga kjo veprimtari (përveç nëse provohet e kundërta), që do të thotë se me këtë dispozitë parashihet përgjegjësia objektive për dëmin i cili ka rrjedhur nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme...

Gjykata, nuk ka mundur që në bazë të shkresave që posedon, që për dëmin e shkaktuar paditësit, të gjejë që të jetë ndonjë fajtor apo ndonjë individ, që ka shkaktuar një dëme të tillë, e nga rrjedh se gjykata nuk ka mundur të gjejë se ekziston lidhja kauzale me dëmin që i është shkaktuar paditësit B., dhe përgjegjësisë së paditurave.

Kjo gjykatë e gjendur para një situate të tillë se duhet të vendosë bazuar në padinë dhe kërkesën e saj, gjen se padia dhe kërkesa e saj duhen refuzuar si të pa bazuara, ku për të paditurat konsideron se ju mungon legjitimiteti real pasiv, e të cilin fakt e kanë kontestuar edhe të paditurat gjatë tërë shqyrtimit kryesor.

Kjo Gjykatë gjatë vendosjes, ka pasur parasysh dhe i ka marrë për bazë pretendimet e palës paditëse se në rastin konkret kemi shkelje të Kushtetutës së Kosovës, Regulloreve...*të (cekura detalisht në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor nga pala paditëse), me të cilat garantohet jeta dhe pasuria e qytetarëve...pra obligimi i të paditurave për sigurinë e qytetarëve, dhe se plagosja lëndore, është si pasojë e lëshimeve të shtetit për sigurinë e jetës së qytetarëve, duke lejuar armë pa leje në duar të qytetarëve...*

Mirëpo gjykata me kujdes ka shtjelluar këto pretendime, (bazuar në ligjet në fuqi të zbatueshme në Republikën e Kosovës- vendimeve të GJDNJ) dhe ka përfunduar se, personi që pretendon se i është cenuar e drejta në jetë..., duhet të dëshmoi se autoriteti e ka ditur, ose është dashur ta dijë, në atë kohë për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm, për jetën e një personi ose personave të identifikuar nga veprat kriminale të një pale të tretë, dhe se ka dështuar të ndërmerri masat brenda fushëveprimit të fuqive të tij (që gjykuar arsyeshëm) mund të jenë pritur ta kenë parandaluar atë rrezik.

Dhe si përfundim Shteti ka obligim që të veproi kur kushtet e paracekura dëshmojnë nga personi... gjegjësisht përfundon gjykata që të paditurat të jenë përgjegjëse në rastin lëndorë, duhet vetëm që të dëshmojnë se autoriteti nuk ka bërë të tërën që mundë të pritët nga ai, brenda arsyes që të parandaloi një rrezik real dhe të menjëhershëm ndaj jetës, për të cilën kanë ose duhet të kenë pasur njohuri...

Andaj kjo gjykatë gjenë se në rastin lëndor, nuk pati ndonjë paralajmërim, apo ndonjë kërkesë për mbrojtje të personit në këtë rast të paditësit, në mënyrë që kjo gjykatë të gjejë se të paditurat kishin bërë shkelje të drejtës për jetë, (specifikisht të Konventes Evropiane), për arsye se të paditurat kishin dështuar që të mbrojnë paditësin...

Gjykata shqyrtoi nenin 14 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, me të cilin decidivisht parashihet, *se në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të egzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryesit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor.*”, andaj, bazuar në këtë dispozitë, gjykata nuk pati prova në shkresa të lëndës që të veproi konformë kësaj dispozite, nuk pati konfirmim nga Prokuroria se kush ishte kryesi/it e kësaj vepre që ishte kryer në dëm të paditësit B., në mënyrë që gjykata të merrte vendim meritor për kryesin/it e kësaj vepre penale..., për këtë arseje gjykata, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që nuk është i ditur kryesi i kësaj vepre penale.

Kjo gjykatë, nuk e shef të arsyeshme që më tutje të shqyrtohet kjo çështje, lidhur me këto pretendime, bazuar në faktin se në shkresa të lëndës, pati prova të mjaftueshme, që vërtetojnë faktin se të paditurat nuk janë përgjegjëse për kompensimin e dëmit për rastin konkret (në

mungesë të ndonjë vendimi), pasi që nuk dihet personi që e ka shkaktuar me veprimet dhe fajin e tij këtë vepër penale).

Ky vlerësim i gjykatës ka mbështetje në provat e administruara e posaçërisht në shkresat parapenale të Prokurorisë Themelore në Pejë, fakt ky që forcon bindjen se gjykata drejt ka vepruar, kur ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa pretendimet e palës paditëse, të dhëna nëpërmes të autorizuarit të tij, dhe provat e tjera që u administruan në procedurën e provave, kjo gjykatë i ka patur parasysh, por të njëjtat i konsideron si të pa ndikim që të vendoset ndryshe nga ajo që është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke i marrë parasysh të lartë cekurat, gjykata ka gjetur se kërkesë padia e paditësit nuk është e bazuar.

Meqenëse nuk pati kërkesë të specifikuar për kompensimin e shpenzimeve procedurale konform dispozitave të nenit 463 të LPK-së, nga të paditurat, atëherë gjykata nuk vendosi për të njëjtat.

Bazuar në arsyet e dhëna u vendos si në dispozitiv.

NGA GJYKATA THEMELORE NË PEJË, C. nr.1601/19, me dt.29.08.2024.

Gj y q t a r j a,
Afërdita Mulhaxha,

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditë, nga dita e pranimit të të njëjtit Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj Gjykate.